

ALBANA MEMA**FILLIMET E DEMOKRACISË INSTITUCIONALE
NË SHQIPËRI NË VITET 1920-1921**

Në vitet 1920 -1921, Shqipëria po hidhte hapat e parë në organizimin e saj shtetëror. Vështirësitë dhe pengesat e kësaj kohe ishin të shumta dhe tepër të komplikuar. Po kaq të komplikuar, kanë qenë dhe ngjarjet politike të kësaj periudhe, për të cilat deri më sot ka pasur analiza dhe këndvështrime të ndryshme. Në këtë artikull do të përqipemi të japim disa të dhëna dhe disa gjykime mbi gjendjen politike të Shqipërisë, me synimin modest se mund t'i shtojmë diçka shkrimeve historiografike rreth kësaj periudhe.

Në këtë kohë u krijuan dhe u konsoliduan institucionet kushtetuese shtetërore. Të rëndësishme ishin: zgjedhjet e para parlamentare, formimi i grupimeve politike dhe veprimtaria e tyre parlamentare. Ky zhvillim solli krijimin e opozitës parlamentare si dhe publikimin e botimeve të para në fushën e të drejtës kushtetuese.

Siç dihet, Kuvendi Kombëtar, i dalë nga Kongresi i Lushnjës, nuk funksionoi mbi bazën e grupeve parlamentare, të ndarjeve politike dhe të konkurrencës së alternativave, por mbi bazën e një platforme të përbashkët të drejtimit politik të vendit. Vetëm në vjeshtën e vitit 1920, do të intensifikoheshin lufta politike në Këshillin Kombëtar dhe do të shfaqeshin grupet e para politike me origjinë parlamentare. Koalicioni i krijuar në Kongresin e Lushnjës u shpërbë para kohe dhe para momentit që ishte parashikuar në këtë Kongres. Kongresi kishte vendosur që, pas njohjes ndërkombëtare të shtetit shqiptar dhe pas caktimit të kufijve të tij, do të zhvilloheshin zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese, e cila do të përcaktonte regjimin politik. Deri në këtë kohë, koalicioni politik i krijuar nga Kongresi i Lushnjës duhej të qeveriste vendin pa u futur në rrugën e konkurrencës politike. Ky përcaktim ishte i domosdoshëm dhe themelor, pasi kishte të bënte me ruajtjen e stabilitetit qeverisës dhe institucional të vendit, deri në caktimin përfundimtar të statusit dhe kufijve të shtetit shqiptar nga Fuqitë e Mëdha. Shkelja e këtij vendimi, sigurisht ishte një dështim i rrezikshëm i klasës drejtuese të kohës. Vendi u detyrua të

shkonte në zgjedhje, në një moment të papërshtatshëm, si në planin e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Në planin e brendshëm, sepse shpërbëri para kohe koalicionin e krijuar në Kongresin e Lushnjës, çka do të kishte pasoja negative për procesin e afirmimit të shtetit të ri, duke krijuar terrenin për diversitetin dhe konfliktin politik, i cili nuk do të vononte të shfaqej rrezikshëm. Në planin ndërkombëtar, pasi zhvilloheshin zgjedhje kur statusi e kufijtë nuk ishin caktuar dhe shteti shqiptar nuk ishte njohur si subjekt ndërkombëtar. Zgjedhjet në këto rrethana krijonin shanse për shtetet fqinje, kundërshtare të Pavarësisë së Shqipërisë, që të ndërhynin dhe të destabilizonin vendin. Këto veprime nuk munguan të shfaqeshin, duke krijuar vështirësi dhe rreziqe të shumta.

Pra, si rezultat i luftës politike, që shpërtheu në gjirin e Këshillit Kombëtar të dalë nga Kongresi i Lushnjës, u miratua ligji i ri i zgjedhjeve dhe u zhvilluan zgjedhjet e para parlamentare. Këto të fundit, çuan në strukturimin e grupeve politike në vend, të cilat konkuronin për vendet në Parlamentin e parë të zgjedhur me votë në Shqipëri. Në këto zgjedhje, “Partia Popullore” u paraqit si subjekt elektoral me një program të hartuar mjaft mirë. Në të njëjtën kohë, një grup deputetësh që iu kundërvu Fan Nolit dhe Ahmet Zogut, krijuan një forcë të re politike, e quajtur “Partia Përparimtare Shqiptare”. Shumë shpejt në gjirin e kësaj partie doli një fraksion i ri, i quajtur “Fraksioni Idependist”, i drejtuar nga Kryeministri Iljaz Vrioni. Ky fraksion, do të ndryshonte edhe raportet politike parlamentare në vend, duke iu bashkuar aleancës me “Partinë Popullore” dhe më vonë, duke bashkëqeverisur me të, Shqipërinë.

Zgjedhjet u zhvilluan gjatë muajit mars dhe prill. Por edhe pse duhet të përfundonin në fillim të prillit, mosmarrëveshjet mes muhamedanëve dhe të krishterëve të Shkodrës, penguan kompletimin e Dhomës së Deputetëve deri më 25 qershor. Diplomatët britanikë, na kanë dhënë një vlerësim interesant dhe realist të karakterit të këtyre zgjedhjeve. Në një raport të tyre thuhej: “Duke patur parasysh, se këto ishin zgjedhjet e para politike në Shqipëri, ato u zhvilluan me më pak influencë (ndërhyrje-A.M.) dhe me më tepër paanësi sesa ishte pritur. Pati abuzime edhe nga zyrtarët edhe nga Bejlerët me influencë, por asgjë e ndodhur nuk ka rëndësinë e një ngjarjeje për t’u shënuar. Incidenti më i rëndësishëm, ishte refuzimi për të votuar, i një pjese të madhe të popullsisë së Korçës, i cili ishte rezultat i dy shkaqeve: Për shkak të propagandës greke, e cila propagandonte se pjesëmarrja në zgjedhje do të thoshte njohja e qeverisë shqiptare, e cila do të dobësonte pretendimet greke në Epir; dhe nga

përpyjekjet e një Partie autonome”.¹ Por, ky përshkrim duhet kuptuar vetëm si një sukses i pjesshëm, madje jo thelbësor. Rreth një vit më vonë, diplomati britanik, H. Smith i kthehej edhe një herë analizës së zgjedhjeve të para, duke na dhënë një përshkrim sa interesant aq edhe rrënjëqethës për fillimet e demokracisë së parë shqiptare. Ai shkruante: “Mendoj se nuk e ekzagjeroj të them që të gjithë deputetët janë caktuar nga lart, votuesit në të dy kategoritë ndjekin verbërisht urdhërat e marra. Edhe në Shkodër, qendra më e shkolluar e Shqipërisë, e gjithë lista e katolikëve ishte e përcaktuar nga liderët e partisë dhe është ndryshuar në momentet e fundit...Me përjashtime të rralla, e gjithë dhoma e Parlamentit konsiston në të nominuar nga pak liderë, të cilët kanë besimin e deputetëve pa asnjë dyshim”.²

Përfundimi i zgjedhjeve të vitit 1921, nuk solli stabilitetin e kërkuar politik në vend. Në muajt që pasuan këto zgjedhje, u ndërruan shumë qeveri.

Sipas britanikëve, pas zgjedhjeve ishte formuar një Dhomë me 79 deputetë, të cilët ishin pjesë e “Partisë Progresive” dhe “Popullore”. Qeveria ishte e mbështetur nga “Partia Progresive”, e cila kishte një shumicë të vogël në Parlament. Në raportin e lartpërmendur thuhej se: “diferenca në qëllime dhe objektiva mes dy partive nuk është e dukshme, por u bë e tillë më vonë, kur “Partia Popullore” iu kundërvu Bejlerëve, dhe ishte e vendosur të luftonte me çdo mënyrë kundër sundimit feudal të tyre”.³ Pas përfundimit të zgjedhjeve në Shkodër më 17 qershor, Dhoma u mblodh më 26 qershor, për herë të parë. Iljaz Vrioni, u thirr nga Këshilli i Regjencës dhe formoi qeverinë e tij të dytë. Sipas britanikëve: “ky ishte kabineti më i fortë i formuar në vend, Sulejman Delvina kishte eksperiencë pasi kishte qenë President i Këshillit, Pandeli Evangjeli është një njeri i nderuar dhe i përshtatshëm për postin e Ministrit të Punëve të Jashtme, ndërsa Z. Kacimbra kishte reputacion të lartë dhe ka qenë President i Dhomës së parë të Deputetëve. I vetmi eksponent i dobët, ishte ministri i Luftës, Selaudin Shkoza”. Ajo që nënvizonin britanikët në veprimtarinë e kësaj qeverie, ishte se “administrimi u ngacmua nga

¹ *The British National Archives* (TNA), Foreign Office (më tej: FO) 371/7332, f. 384-394, Raport vjetor për vitin 1921, H.C.A. Eyres, Durrës, dt. 1 maj 1922, për Marquess Curzon of Kedleston.

² FO 371/7330, f. 581-586, Telegram i Heathcote Smith për Curzon, dt. 18 janar 1922, mbi situatën politike në vend.

³ Po aty.

problemet e brendshme dhe të jashtme, që nga momenti i krijimit të qeverisë. Kryengritja e Mirditës dhe sulmet e vazhdueshme nga Serbët në kufi, sollën pengesa shumë të mëdha për tu kapërcyer nga shtetarë pa eksperiencë”.⁴

Megjithëse, parlamenti ishte parashikuar të krijohet pas një Asambleje Kushtetuese, jo përpara, mbledhja e një Asambleje të tillë, në këtë kohë, ishte e pamundur, pasi pozitat ndërkombëtare të Shqipërisë ishin të paqarta. Ato do të qartësoheshin, vetëm në fund të vitit 1921, pas vendimit final të Konferencës së Ambasadorëve. Megjithatë, parlamenti kishte pak rëndësi, përderisa lufta kryesore bëhej në nivelin e kabinetit, me konkurrencë interesash, duke luftuar për të fituar kontrollin mbi pozitat kyçe dhe luksin që krijonte pushteti politik.

Nga këto zgjedhje, në mënyrë të natyrshme, u krijua një shumicë parlamentare qeverisëse dhe opozita e asaj kohe. Të dyja këto mund të cilësohen, as më pak dhe as më shumë, si një lindje prematurë dhe në rrethana tepër të vështira e një sistemi demokratik parlamentar, të cilat kishin tendencën ta dobësonin, madje edhe mund ta vrisnin organizmin e brishtë të shtetit shqiptar. Kjo do të kishte pasoja negative, të cilat do t'i trajtojmë më poshtë.

“Partia Popullore” dhe “Partia Përparimtare” nuk u ndërtuan dhe nuk funksionuan si parti, as në strukturë dhe as në veprimtarinë e tyre. Asnjëra prej tyre nuk arriti të ndërtonte struktura parlamentare dhe të realizonte një proces zgjedhjesh brenda vetes. Prandaj historiografia jonë, me të drejtë, ka ngurruar t'i trajtojë me statusin e partive të mirëfillta. Ajo që formonte identitetin e tyre si forca politike, ishte identifikimi me emrat e drejtuesve të tyre.

Situata në atë kohë ishte shumë fluide. Etniciteti, feja dhe përkatësia klanore, kishin më shumë peshë se sa përkatësia partiake por, edhe këta faktorë nuk ishin përcaktues. Personalitetet dhe interesi vetjak i deputetëve, ishte kryesori. Shekujt e korrupsionit otoman u kishin mësuar shqiptarëve se një post politik nënkuptonte pasuri dhe deputetët nuk turpëroheshin me metodat që zbatoheshin për përfitimin e saj. Deputetët ja dinin për nder zgjedhjen e tyre, klanit ose influencave rajonale dhe përfitimet nga posti i shërbenin për të rritur prestigjin dhe influencën lokale, kështu që ishin të interesuar për t'u renditur në anën e fituesit.

⁴ Po aty.

Parlamenti, në rastin më të mirë, mund të thuhet se ishte një lustër mbi politikat për pushtet.

Në fillim të vitit 1922, diplomatët britanikë, bënë një analizë të detajuar dhe me pikëpamje më të konsoliduara, rreth situatës dhe grupeve politike gjatë vitit 1921. H. Smith njoftonte Lordin Curzon mbi situatën politike në vend ose për atë që ai e quante “imagjinata e qeverisjes parlamentare”. Në raportin e tij thuhej: “Demokracia në Shqipëri është duke u ngushtuar dhe përqendrohet në Tiranë. Do të përpiqem të ekzaminoj forcat që ndodhen pas përfaqësuesve të popullit”. Më tej ai vijonte: “ Në dukje Shqipëria paraqitet sikur ka liderë politikë në kuptimin demokratik, por kjo nuk është e vërtetë. Fuqia e një lideri nuk varet nga votat, por nga pushkët. Homazhi i idealeve perëndimore të demokracisë që ka të bëjë me respektimin e metodave parlamentare të opozicionit, për aq sa mund të jetë sukses, është i parakohshëm; dalin në pah fuqitë e armatosura, siç ishte rasti i krizës së fundit...Për sa kohë, arësyet e mosmarrëveshjeve janë personale, më tepër për të marrë pushtet, sesa për të vendosur një politikë të veçantë, bashkimet dhe shpërbërjet mes liderëve e kanë të vështirë të qëndrojnë në paqe, për sa kohë, që bashkimet dhe ndarjet varen nga oportunitizmi, me arritjen e postit si qëllim kryesor”.⁵

Shihet se gjendja e institucioneve përfaqësuese, ishte mjaft fluide dhe se niveli i përgjegjshmërisë politike e shtetformuese të elitës politike shqiptare, ishte i ulët. Mungesa e një kuptimi të thellë për politikën dhe institucionet kombëtare, paaftësia për të ndërtuar konsensusin politik, mungesa e perspektivës për zhvillimin e vendit dhe paaftësia për të kuptuar nevojën për stabilizimin e shtetit dhe institucioneve kombëtare, në atë fazë tepër të vështirë të zhvillimit të vendit, dominimi i egoizmit individual mbi parimet e ndërtimit dhe funksionimit ligjor të institucioneve, etj., ishin tipare të rëndësishme negative të elitës politike të kohës.

Misioni britanik, u përpoq që të kuptonte edhe se cilat ishin grupet më kryesore politike gjatë vitit 1921. Në qendër të analizës së këtij konstelacioni politik, ai vendoste “Partinë sekrete”- “Klika”. Në raportin e tij thuhej se: “A. Zogu, që ishte një anëtar i fuqishëm i “Partisë Popullore”, menjëherë pas mbledhjes së Parlamentit, formoi atë që këtu njihet si “Klikë”. Ajo është një shoqëri sekrete dhe krahasohet me shoqëri

⁵ Po aty.

të tjera jashtë vendit, me “Komitetin turk të Bashkimit dhe Përparimit”. Anëtarët më të njohur të saj janë: Ahmet Bej Zogolli i Matit, për momentin Ministër i Punëve të Brendshme; Eshref Bej Frashëri, për momentin President i Dhomës së Parlamentit; Kolonel Maliq Bej Frashëri, në këto momente drejtues i stafit; Kolonel Xhavit; Kolonel Ismail Tatzati, tani Ministër i Luftës; Xhafer Bej Ypi, tani Kryeministër; Bajram Fevzi, më parë Ministër i Punëve të Brendshme; Sotir Peci, i krishterë nga Korça, për momentin Regjent; Kol Thaçi, i krishterë nga Korça, tani Ministër i Financave; Mustafa Maksuti, më parë zëvendës Ministër i Luftës; Rexhep Bej Mitrovica, tani Ministër i Edukimit”.

Smith, në funksion të perceptimit të tij për “Klikën”, si organizatë e fshehtë, madje edhe me një profil antiligjor, shtonte se prefekti i Durrësit, Rexhep Jella, i kishte thënë konfidencialisht një javë më parë, se Kryeministri, në emër të Ahmet Zogut, e kishte ftuar atë të bashkohej me “Klikën”, duke i thënë që, nëse vepronte kështu, do të siguronte karrierën e tij. Jella, i tha Smith, se kishte refuzuar, duke u përgjigjur se një zyrtar s’duhet t’i përkiste asnjë partie. Gjithashtu, Jella i deklaroi Smith se në atë kohë ai kishte refuzuar të toleronte edhe disa arrestime arbitrare të urdhëruara nga “Klika”, për arsye politike, të cilat do të kryheshin në prefekturën e tij.

Diplomati britanik nënvizonte depërtimin e “Klikës” në ushtri. Sipas tij, ”prania e tre zyrtarëve ushtarakë të rëndësishëm në “Klikë”, ishte tregues që ushtria ishte e përzjerë me politikën”. Ai pohonte se: “ç’do veprim i anëtarëve të “Klikës” bëhej për marrjen e pushtetit dhe të pasurisë, për anëtarët e saj, dhe asnjë mjet nuk konsiderohej i paligjshëm për të realizuar këtë qëllim”. Smith parashikonte edhe tendencën e pritshme në raportet midis grupeve politike. Ai sqaronte se: “ngjarjet e fundit kishin provuar që, çfarëdo organizatash sekrete që do të krijoheshin nën pushtetin e Hasan Beut ose të një lideri tjetër, nëse ndodhte diçka e tillë, ata për momentin do të ishin në kundërshtim me “Klikën”.⁶ Kjo do të thoshte se ai mendonte se konflikti do të ishte i pashmangshëm.

Një përshkrim interesant partive të reja i ka bërë edhe M. Kruja i cili ishte njëri ndër opozitarët më njohur dhe aktivë të asaj kohe. Ai thekson se: “Promotor i themelimit të “Partisë Popullore” ishin njerëzit e komitetit të fshehtë “Krahu Kombëtar”. “Partia Popullore” përfaqësonte

⁶ Po aty.

më tepër krerët e Jugut, të cilët i kishin shtrirë dorën A. Zogut, pasi nga pikëpamja patriotike, nuk mund të thuhej asgjë negative për të”. Kruja pranonte se kjo parti, kishte një program për reforma përparimtare. Ndërsa për partinë tjetër, e cila u formua në gjirin e Parlamentit të Parë shqiptar dhe që u quajt “Partia Përparimtare”, ai shprehet se, ajo përbëhej kryesisht nga elementët më konservatorë të atij parlamenti, kishte si lider, beun më të fuqishëm të Shqipërisë, Shefqet Vërlacin dhe si ideolog Mehdi Frashërin. Kruja evidentonte se ekzistonte edhe një grup i pavarur, grupi i Shkodrës dhe i Bunës, me 10 deputetë, midis të cilëve kishte edhe intelektualë progresistë si: Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Luigj Gurakuqi, Mustafa Kruja, të cilëve, “Partia Popullore” u bëri thirrje disa herë të bashkoheshin me të, por këta nuk pranuan. Më vonë, vetë M. Kruja, e quante një gabim të rëndë këtë qëndrim. Madje, ai shton se, më vonë ky u shndërrua në një faj të rëndë, kur me këmbënguljen e Bajram Currit dhe të Hasan Prishtinës, këta u bashkuan me “Partinë Përparimtare”, me të cilën, nuk kishin asgjë të përbashkët dhe ishin “krejtësisht në shtëpi të huaj”.⁷ Lidhur me Krahun Kombëtar apo “Klikën” një kundërshtar tjetër politik i saj, A. Këlcyra, ka dhënë një vlerësim shumë më negativ se sa M. Kruja. Ai e ka quajtur atë: “një organizatë të fshehtë dhe të rrezikshme në trupin e kombit shqiptar”.⁸

Studiues të huaj, e kanë konceptuar “Klikën”, si një organizatë të tipit masonik, e cila ishte e bashkuar vetëm nga interesa të ngushta politike. Jason Tomes thekson se: “sapo qeveria shpallte emërimet e saj, njerëzit e pakënaqur fillonin të komplotonin për ta përmbysur atë, disa vepronin përmes një organizate të tipit masonik që quhej “Klika”, e cila ishte shtylla e shumicës”. Ai nënvizon se, “kjo organizatë, e cila i kishte fillesat në periudhën otomane, luajti një influencë të dukshme në vitet 1920-1924”.⁹

Në këtë kontekst të klasës politike shqiptare, edhe opozitarizmi paqësor dhe luajal thuajse nuk ekzistonte. Intriga, gjatë kësaj periudhe, në disa raste, degradoi në veprime kriminale. Çdo individ i angazhuar në politikë ishte i armatosur, ndërsa figurat kryesore kishin pas vetes banda dhe roje të rekrutuar në zonat e tyre. Luginat e maleve ishin rezerva

⁷ Mustafa Kruja, *Anthologji historike*, Elbasan: Sejko, 2001, f. 296.

⁸ Ali Këlcyra, *Shkrime për historinë e Shqipërisë: kujtime politike, si dhe shkrime të tjera e letërkëmbimi*, Tiranë: Onufri, 2012, f.85.

⁹ Jason Tomes, *King Zog of Albania - Europe's self-made Muslim Monarch*, USA: New York University Press, 2003, f. 45.

luftëtarësh, për të cilët qeveria kombëtare nuk perceptohej ndryshe vetëm si “njerëzit e Tiranës”. Ata respektonin shefin e tyre si sunduesin legjitim, çdo gjë tjetër, cilësohej si tirani e huaj. Ishte e lehtë që politikanët e frustruar t’i ngrinin ata në rebelim, duke i bërë thirrje besnikërisë së tyre dhe premtimeve për pasuri. Agjentët grekë, serbë dhe italianë, ishin të gatshëm të “ndihmonin” me para në dorë. Mbështetja dhe shitja tek të huajt, me ose pa ndërgjegje, ishte një fakt bazik i jetës politike.

Krijimi i grupeve opozitare në organet përfaqësuese, siç janë Parlamenti ose senati, kuptohet që janë një karakteristikë themelore dhe funksionale e regjimeve parlamentare. Por, problematike për Shqipërinë, ishte fakti se këto grupime nuk ishin krijuar si rezultat i shtresëzimeve politike brenda vendit, por ishin grupe të ndërtuara mbi bazën e përkatësive krahinore dhe lidhjeve personale.

Në çdo shoqëri demokratike, veprimtaria e opozitës, ka rëndësi vendimtare për shkallën e suksesit të ndërtimit, afirmimit dhe konsolidimit të institucioneve kombëtare. Krahasuar me opozitat e vendeve të fuqishme demokratike, opozita shqiptare kishte disa mangësi esenciale dhe strukturale. Ajo nuk kishte një lider gjithëpërfshirës, fryma politike e opozitës, mbahej e gjallë nga një grupim intelektualësh dhe shumica e elektoratit të saj, ishte shumë e paqartë rreth qëndrimeve të tyre.

Në një raport të gjatë politik vjetor, H. Eyres përshkruan si aftësitë dhe veprimet e qeverisë, ashtu edhe ato të opozitës gjatë vitit 1921, deri kur ajo do të zëvendësohej me një qeveri koalicioni. Ai bënte këtë përshkrim për qeverinë e I. Vrionit që ishte në atë kohë në fuqi: “Iljaz Bej Vrioni ishte kryesisht një burrë i ndershëm dhe qëllimet e tij ishin të shkëlqyera. Ai ishte një patriot shqiptar i gjithanshëm dhe idetë e tij ishin të shkëlqyera dhe liberale. Por, kishte një difekt të madh, dobësinë e karakterit dhe të vendimmarrjes. Urdhërat e tij u shpërfillën dhe ai dështoi në marrjen e veprimeve të forta, kur ishte e nevojshme. Ai gjithashtu, ishte i prirur t’u lejonte bejlerëve dorë të lirë, në zbatimin e praktikave të tyre të pandershme dhe shtypëse. Pranimi prej tij, i Selaudin Beut, si Ministër i Luftës, ishte shkak i parë i rënies së tij të fundit nga pushteti. “Partia Popullore” ia ngarkonte fajin këtij ministri me simpati qemaliste dhe pohonte se ai është përpjekur të sjellë nga Turqia 120 oficerë për të zënë vendet kryesore në milici. Ai nuk të jepte përshtypjen e të qenit intrigant, por me shumë mundësi, ishte simpatizant me aspiratat Qemaliste. Në çdo rast, Parlamenti, nuk do të kishte asnjë përfitim prej tij

dhe rënia e kabinetit të tij, ishte kryesisht rezultat i dëshirës për t'u distancuar nga kolegët e tyre. Mehdi Beu është një njeri i zgjuar, dhe në të vërtetë, i vetmi njeri në Shqipëri, për momentin në qeverinë aktuale, i pajisur me artin e të qeverisurit. Ai është njeri i biznesit dhe i zoti në bërjen e negociatave siç bënte biznes. Por, një njeri i varfër dhe subjekt i joshjes ndaj varfërisë së tij. Ai nuk është, fatkeqësisht, i besueshëm, por dredharak dhe i paqëndrueshëm dhe mendohet se është i hapur ndaj rryshfeteve”.¹⁰

Eyres përshkruante dhe vështirësitë e qeverisjes në këtë kohë, për të cilat, pohon se ishin kryesisht të jashtme: “Ata e gjetën veten shumë të penguar nga pushtimi serb në zonën e armëpushimit, të cilën serbët, duket se e konsideronin shumë fleksibël, aq sa largoheshin nga disa zona dhe pushtonin disa të tjera sipas leverdisë së tyre. Kishte gjithashtu kërcënime për trazira edhe në kufirin grek, propaganda dhe agjentët grekë ishin tepër aktivë në Gjirokastrë dhe Korçë. Për më tepër, pamundësia e arritjes së një marrëveshjeje me Italinë, ishte shkak i shqetësimeve të mëdha”. Por, ai nuk mohonte as vështirësitë e brendshme, “për shkak të mungesës së njerzve me kapacitet administrativ dhe vështirësive financiare”. Eyres pohonte se: “zyrtarët e caktuar si Prefektë, varionin nga inkompetentë dhe dembelë, në patriotë të nxehtë dhe të palëkundshëm, energjia e të cilëve, ishte shpesh e gabuar”.¹¹

Ndonëse, Eyres dhe kolegët e tij, e shikonin qeverisjen parlamentare në Shqipëri, si një farsë, ata bënë një vlerësim disi më të moderuar për funksionimin e Parlamentit gjatë vitit 1921, duke evidentuar zhvillimin e qetë dhe me kulturë të seancave parlamentare në këtë fazë të parë. Lidhur me këtë Eyres shkruante: “Dhoma e Deputetëve nuk është cilësuar për ndonjë rekord në legjislacion, gjatë këtij viti. Por, ka zhvilluar diskutime politike, për të cilat, të gjithë shqiptarët janë përgjegjës”. “Megjithatë, vazhdon ai, ndoshta, ishte e tepërt të shpresoje që deputetët, të cilët ishin parlamentarë krejtësisht të rinj, do të kishin sjellë ndonjë efekt të madh, për më tepër edhe kur vendi ka qenë nën kërcënimin e luftës për gjatë gjithë gjysmës së vitit, dhe çështja e kufijve akoma nuk ka përfunduar. Por, diskutimet janë zhvilluar me dinjitet dhe rregull dhe sjellja e

¹⁰ FO 371/7332, f. 384-394, Raport vjetor për vitin 1921, H.C.A. Eyres, Durrës, dt. 1 maj 1922, për Marquess Curzon of Kedleston.

¹¹ Po aty.

deputetëve krahasohet favorshëm me sjelljen dhe debatet në Parlamentet e vendeve fqinje”.¹²

Si rezultat i një rreziku evident të jashtëm, dhe kjo për herë të parë në historinë politike të Shqipërisë, që nga periudha e Pavarësisë, në tetor 1921, u krijua një koalicion i gjerë politik midis pozitës dhe opozitës, i njohur si “Bashkimi i Shenjtë”. Por ky koalicion, do të ishte i përkohshëm. Ai shumë shpejt, do t’ia linte vendin një krize të gjatë dhe të thellë institucionale.

Për krijimin e këtij koalicioni, ka pasur mendime të ndryshme dhe kontradiktore, si në atë kohë edhe më vonë në trajtesat historiografike. Njëra palë, e ka parë atë, si një kurth, të ngritur nga opozita për të marrë në dorë pushtetin, ndërsa pala tjetër, si një domosdoshmëri, për të bashkuar forcat dhe për të eliminuar kundërshtitë politike, me qëllim që t’i jepej mundësi qeverisë të shtypte rebelimin e nxitur nga Jugosllavia, në Mirditë. Njëri nga politikanët kryesorë të asaj kohe dhe një nga drejtuesit e “Partisë Popullore”, Sejfi Vllamasi, shkruante: “Situata parlamentare nuk e lejonte partinë e opozicionit të formonte një qeveri, pasi nuk e kishte shumicën. Për këtë ata menduan krijimin e “Bashkimit të Shenjtë” dhe parlamenti t’ia lerë kompetencën e formimit të qeverisë, një komisioni të përbërë prej: Bajram Currit, Avni Rustemit dhe Qazim Koculit. Me gjithë absurditetin e kësaj ideje, “Partia Popullore” e pranoi formimin e këtij komisioni, prej të cilit lindi qeveria e Pandeli Evangjelit, e cila, pas pak kohe, u përmbys me anën e një grushti shteti. Në këtë komplot morën pjesë: Këshilli i Naltë (Aqif Pasha me Luigj Bumçin), Qazim Koculi, Hasan Prishtina, Mustafa Kruja dhe gjithë opozita kryengritëse”.¹³

Ndërsa, drejtuesit e opozitës së asaj kohe, kanë mbrojtur pikëpamjen tjetër, atë të domosdoshmërisë së bashkimit për të stabilizuar gjendjen e brendshme të vendit në ato momente kritike. A. Këlcyra ka dhënë një version disi më të ndryshëm të kësaj ngjarjeje. Sipas tij: “me 3 shtator 1921, në një mbledhje në Vlorë, për festimin e përvjetorit të parë të fitores mbi italianët, pa u menduar shumë për përfundimet, u vendos të bëhej një lidhje midis demokratëve intelektualë, për formimin e një qeverie me tendenca më të theksuara për realizimin e reformave

¹² Po aty.

¹³ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, përgatitur për botim nga Marenglen Verli, Tiranë: Neraida, 2000, f. 409.

shoqërore. Kjo u quajt “Bashkimi i Shenjtë”, i cili dështoi kryekëput në realizimin e qëndrimit të saj”.¹⁴ Ndërsa M. Kruja, e quan këtë, “si një tentativë bujare prej një grupi të vogël patriotësh dhe si një besë politike ndërmjet dy partive, brenda dhe jashtë Parlamentit, deri sa të merrnin fund të gjitha problemet ndërkombëtare të Shqipërisë”.¹⁵

Siç shihet qartë, ka një ndryshim themelor, midis parashtrësës së këtyre dy krerëve të opozitës së asaj kohe. Njëri e paraqet “Bashkimin e Shenjtë”, si një koalicion të krijuar për reformat e brendshme politiko-shoqërore dhe tjetri, për stabilizimin e situatës së jashtme të Shqipërisë.

Diplomati britanik, H. Smith kishte një perceptim tjetër për krijimin e “Bashkimit të Shenjtë” dhe për tendencat politike në vend. Si një grup që nxiti këtë bashkim ai cilësonte të krishterët e Jugut, të cilët i cilësonte si “të paarmatosur midis të armatosurve”. Ata, duke e parë pafuqinë e tyre kundrejt myslimanëve, e shtuan fushatën kundër bejlerëve. Ndërsa, “Ahmet Beu, si person i mprehtë që ishte, përfitoi nga kjo lëvizje për tu bashkuar me “Bashkimin e Shenjtë”, i cili u krijua për t’i dhënë fund pushtetit të bejlerëve, edhe pse Zogu përfaqësonte tipin më ekstrem të bejlerëve që duheshin shtypur”. Smith pohonte se Fan Noli u integrua në “Partinë Popullore” për qëllime praktike dhe pastaj në përbërjen e “Bashkimit të Shenjtë”. Gjithashtu ai përmend edhe katolikët si pjesë e këtij skenari, për të cilët thotë se ishin kryesisht nga Shkodra, dhe mendonin që po bashkoheshin me lëvizjen antibejlere. Më tej përmend edhe grupin e kosovarëve të cilët ishin proitalianë. “Tipari më kryesor i grupit të Hasan Beut, ishte karakteri i tij i hapur, pro-italian,” theksonte Smith.¹⁶ Pikëpamja e Smith për Zogun, si një arkitekt dhe përfitues prej “Bashkimit të Shenjtë”, megjithëse është interesante dhe duhet verifikuar më tej, bie në kundërshtim të plotë me atë që ka shkruar S. Vllamasi, i cili thekson se Zogu ishte kundërshtar i kësaj lëvizje politike dhe se kishte paralajmëruar rrezikun e një grushti shteti pas saj.

Gjithsesi, duke gjykuar se çfarë ndodhi më vonë, ky ishte një fillim i gabuar dhe i rrezikshëm i opozitës së parë shqiptare.

Në fund të vitit 1921, situata e jashtme e Shqipërisë po përmirësohej, por pikërisht në këto momente, iniciatorët e “Bashkimit të Shenjtë” po

¹⁴ A. Këlcyra, *Shkrime për historinë e Shqipërisë ...*, f. 85.

¹⁵ M. Kruja, *Anthologji historike ...*, f. 297.

¹⁶ FO 371/7330, f. 581-586, Telegram i Heathcote Smith për Curzon, dt. 18 janar 1922, mbi situatën politike në vend.

përpiqeshin të shpërndanin Parlamentin dhe të merrnin në dorë qeverinë, me anë të një grushti shteti. Sipas M. Krujës, ata kishin mbetur të pakënaqur pasi kryeministri ishte anëtar i “Partisë Popullore”, se dy ministrinë më të rëndësishme, atë të Punëve të Brendshme dhe të Luftës i kishte kjo parti dhe në krye të tyre ishin oficerë të Krahut Kombëtar që kundërshtarët e quanin “Klika”.¹⁷

Emërimi i Zogut si Komandant i Përgjithshëm i forcave ushtarake për të shtypur rebelimin në Mirditë, pa dekret të Këshillit të Naltë, shërbeu si shkëndija e fundit dhe njëkohësisht si pretekst, për të filluar përpjekjet për grushtin e shtetit. Më 4 nëntor 1921, komplotistët, duke mashtruar edhe P. Evangjelin, provokuan mbledhjen e Parlamentit, me justifikimin se qeveria do të bënte një ekspozë mbi situatën e jashtme të Shqipërisë. Deputetët mbetën të befasuar, kur në vend të raportit të qeverisë, u lexua dekreti i Këshillit të Naltë, mbi shpërndarjen e Parlamentit deri më 4 janar 1922, me motivacionin se, “qeveria ka nevojë të ketë liri veprimi për të përballuar situatën e krijuar në kufirin me Jugosllavinë”. Parlamenti e kundërshtoi ashpër këtë dekret por, duke mos dashur ta çonte punën deri në gjakderdhje, ndonëse e refuzoi dekretin si jashtë statutit, vendosi ta pushojë aktivitetin e tij, deri më 1 janar 1922.

Pas shpërndarjes së Parlamentit, iniciatorët e “Bashkimit të Shenjtë”, që ishin njëherësh edhe qendra e komplotit për realizimin e grushtit të shtetit, shtynë Ahmet Daklin (ministër i Financave) dhe Zija Dibrën (ministër i Punëve Botore) të jepnin dorëheqjen me qëllim që të rrezonin qeverinë e P. Evangjelit. Në këtë kohë, rebelimi antikombëtar në Mirditë, ishte shndërruar në një rrezik të madh për shtetin shqiptar. Qeveria e P. Evangjelit krijoi dy komanda, në krye të cilave emëroi A. Zogun në Lindje dhe B. Currin në Perëndim. Por, Aqif Pasha nuk pranoi të legalizojë emërimin e A. Zogut, ndërsa qeveria e quajti emërimin e tij kompetencë të saj dhe e emëroi pa pëlqimin e Këshillit të Naltë.

S. Vllamasi ka shkruar se: “në krye të këtij komploti ishte pjesa më radikale dhe e dhunshme e opozitës. Por, nuk ishte vetëm ajo. Në komplot u përfshinë edhe dy pjestarë të Këshillit të Naltë, i cili ishte një krijesë konsensuale e Kongresit të Lushnjës. Kështu grupi i “Partisë Përparimtare” formoi një komision me Hasan Prishtinën, Mustafa Krujën, Riza Danin, Ramiz Dacin e Irfan Ohrin, të cilët hynë në bisedime me prefektin e Vlorës, Qazim Koculin dhe i propozuan krijimin e një

¹⁷ M. Kruja, *Anthologji historike ...*, f. 297.

qeverie të re, pasi të përmysej qeveria e P. Evangjelit, me anë të një grushti shteti. Pasi Q.Koculi pranoi, Këshilli i Naltë me në krye Aqif Pashën dhe krerët e tjerë të komplotit, e kërcënuan P. Evangjelin të jepte dorëheqjen. Ky pranoi të jepte dorëheqjen me t'u mbledhur Parlamenti. Kjo përgjigje nuk i kënaqi dy anëtarët e Këshillit të Naltë, Aqif Pashën dhe Imzot Bumçin, të cilët, më 6 dhjetor 1921, "pushuan nga puna" Kryeministrin Pandeli Evangjeli, me argumentin se kabineti kishte rënë pas dorëheqjes së ministrave të tij. Ata caktuan si Kryeministër Qazim Koculin. Meqë Pandeli Evangjeli kundërshtoi të jepte dorëheqjen, Aqif Pasha i kërkoi major Ismail Haki Kuçit të vinte me forcat e tij në Tiranë, pasi kështu e kërkonte interesi i shtetit, pa i treguar se çfarë detyre konkrete do të kryente. Ky, duke pasur një besim të plotë tek Aqif Pasha, erdhi në Tiranë. Në atë kohë qeveria dispononte fare pak forca ushtarake, një kompani ushtarësh nën komandën e Osman Gazepit dhe 150 xhandarë të grumbulluar nga Jugu për të shkuar në vijën e demarkacionit. Nën urdhrin e Aqif Pashës ishte një kompani e disiplinës, një fuqi prej 250 gollobordasish nën komandën e Dan Camit si dhe disa emigrantë dibranë. Komandanti i Përgjithshëm i xhandarmërisë, nënkolonel Ali F. Kosturi, ishte në dijeni të komplotit dhe e simpatizonte atë, por duke dashur të mbetej jashtë përgjegjësisë plagosi veten në këmbë dhe dha dorëheqjen".¹⁸

Shpërndarja e komandës së forcave të armatosura në duart e forcave politike kundërshtarë, ishte baza më e përshtatshme për grusht shteti por, njëherësh edhe një rrezik për shkatërrimin e institucioneve të sigurisë dhe për fillimin e një lufte civile. Kësaj tabloje të errët institucionale i shtoi edhe disponimi i forcave të armatosura vullnetare nën komandën e këtyre krerëve kundërshtarë.

Më tej, në lidhje me grushtin e shtetit, S. Vllamasi vazhdon: "Organizatorët e grushtit të shtetit dërguan Hasan Prishtinën, Mustafa Krujën dhe Ramiz Dacin në hotel "Internacional", ku gjendej Kryeministri bashkë me Qazim Koculin dhe Kol Tromarën, përkatësisht prefekti i Vlorës dhe i Gjirokastrës. Më pas, sipas planit të organizuar, major Ismail H. Kuçi, në krye të civilëve dibranë, zbriti me zhurmë e furi nga rruga e Dibrës dhe bashkë me forcat e tjera civile e ushtarake rrethoi hotelin "Internacional". Ministri i Brendshëm, Bajram Fevziu dhe zv.ministri i Luftës, Mustafa Maksuti, i sugjeruan P. Evangjelit të

¹⁸ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 258-260.

përdorej forca kundër atyre që kishin rrethuar qeverinë, por ai refuzoi gjakderdhjen, pasi në këtë kohë Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve ishte në Shqipëri dhe mund të njoftonte mbi paaftësinë e vendit për qeverisje të stabilizuar. Nën kërcënimin e armëve, ai u detyrua të jepte dorëheqjen, të cilën ia dorëzoi Kol Tromarës.

Dy anëtarët e Këshillit të Naltë që organizuan grushtin e shtetit, emëruan si Kryeministër Qazim Koculin, i cili me të filluar nga puna dha urdhër të mos shpërndahej asnjë telegram i pakontrolluar me qëllim që të evitonte përhapjen e lajmeve brënda e jashtë vendit. Por shpejt ai e kuptoi situatën e rrezikshme në të cilën ishte futur dhe dha dorëheqjen¹⁹.

Sipas M. Krujes, ““Klika” alarmoi Shqipërinë, duke njoftuar se në kryeqytet kishte ndodhur një grusht shteti. Qazim Koculit i mbërrinë telegramet si breshni prej Jugut, të cilët e shtërnguen me dhanë dorhekjen në krye të 24 orëve e me u nisur për në Vlorë”²⁰.

“Dorëheqja e papritur e Koculit, vuri në vështirësi të madhe organizatorët e grushtit të shtetit, të cilët për hakmarrje organizuan një atentat për eliminimin e tij, të cilit Koculi i shpëtoi rastësisht. Pas dorëheqjes së Qazim Koculit, Këshilli i Naltë ngarkoi Hasan Prishtinën për formimin e kabinetit. Hasan Prishtina formoi më 7 dhjetor qeverinë e tij, me Zija Dibrën, ministër Luftë, Luigj Gurakuqin, ministër të Brendshëm, Hoxha Kadrinë, ministër të Drejtësisë dhe Fan Nolin, ministër të Jashtëm. Në fakt, Fan Noli u vu në listën e ministrave pa dijeninë e tij”²¹.

Me rëndësi është të theksohet se, diplomatët britanikë, e quajtën këtë, pa hezitim, si grusht shteti. Heathcote-Smith i dërgoi këtë telegram Forin Ofisit: “Ndryshimet në kabinet kanë natyrën e një *coup d’etat*, të ndikuara nga Këshilli i Regjencës. Me bazën se qeveria e tij nuk ishte e plotë, ish-kryeministri pranoi të japë dorëheqjen, pasi siç duket Regjenca shfaqti forcë. Kryeministri i ri u vendos me një kabinet të plotësuar. Kryeministri, ministri i drejtësisë dhe ministri i luftës janë nga vilajeti i Shkupit. Kabineti i ri është serbofob dhe dukshëm italoofil. Kjo krizë e rrezikshme, ka ardhur kryesisht nga rivalitetet personale”. Po kaq interesant, është gjykimi i Smith se, “Kabineti i ri, sidoqoftë, pritet të

¹⁹ *Po aty*, f. 260-261.

²⁰ M. Kruja, *Anthologji historike ...*, f. 298.

²¹ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 261.

trajtojë efektivisht çështjen e asamblesë kushtetuese dhe të formës së qeverisjes që do të adoptohet”.²²

Lajmi i grushtit të shtetit dhe i formimit të kabinetit të Hasan Prishtinës, u prit me zemërim në të gjithë vendin, ku u organizuan protesta, të cilat ishin më të forta në kryeqytet. Shefat e zyrave dhe të gjithë nëpunësit, në shenjë proteste, lanë detyrën e tyre dhe u bashkuan me banorët e kryeqytetit, duke kënduar këngë kombëtare dhe hodhën parullat “Poshtë agjentët e Italisë”. Kjo akuzë, i drejtohej në radhë të parë H. Prishtinës, duke pasur parasysht aventurën e tij të rrezikshme të armëve në vitin 1920. Në këto rrethana, edhe F. Noli nuk pranoi të merrte përsipër postin e ministrit të Punëve të Jashtme, ndërsa Luigj Gurakuqi, i caktuar ministër i Punëve të Brendshme ndodhej atëherë jashtë vendit. Me qëllim që të shmangej kriza, kur qeveria ende nuk kishte filluar punën, këto dy portofole themelore u ndanë midis Kryeministrit H. Prishtina, i cili mori edhe funksionin e ministrit të Jashtëm dhe ministrit të Drejtësisë, Hoxha Kadriu, i cili mori edhe postin e ministrit të Brendshëm. Pra, postet më të rëndësishme të qeverisë, u përqendruan kështu në duart e dy udhëheqësve kryesorë të Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, çka rrezikonte të çonte edhe në tensionimin e situatës me Jugosllavinë. Tirana gjendej në anarki dhe forcat civile të Aqif Pashës, Hasan Prishtinës dhe Mustafa Krujës sundonin qytetin.

Situatën kaotike në Shqipëri e konfirmonte edhe Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve, i cili raportonte: “Situata politike në Shqipëri në këto momente, nuk është e qartë dhe mungesa e gazetave e bënë të vështirë punën e Komisionit për të qëndruar në kontakt me opinionin publik në të gjithë vendin. Më 7 dhjetor, pas një mosmarrëveshje me Regjencën, Pandeli Evangjeli u detyrua të jepte dorëheqjen. Ai fillimisht nuk dëshironte ta bënte një gjë të tillë, por për të evituar trazira, të cilat do të kishin sjellë pasoja të rënda, ua hapi atyre rrugën dhe një qeveri e re u formua nën kryesinë e Hasan Prishtinës. Ngaqë ky i fundit, në përgjithësi ishte jopopullor në vend dhe për shkak të frikës se prezenca e tij në qeveri mund të sillte komplikacione të jashtme, në Tiranë u zhvillua një manifestim kundër tij”. Por, Komisioni kishte përshtypjen se raportet e ekzagjeruara rreth këtij manifestimi që qarkullonin në shtyp, u bënë për të demonstruar se një gjë e tillë nuk u shoqërua nga dhuna apo

²² FO 371/5735, f. 1460, Telegram i Heathcote-Smith për FO, mbi formimin e kabinetit të ri, dt. 9 dhjetor 1921.

gjakderdhja. “Megjithatë Hasan Prishtina e pati të pamundur të qëndronte në krye të qeverisë dhe dha dorëheqjen, pas katër ditëve”. Më tej, po ky komision, vërente se: “Dorëheqja e Pandeli Evangjelit, duket se ka sjellë një ndjenjë të fortë kundër Regjencës, por është e pamundur për momentin, të parashikosh ngjarjet që do të ndodhin në të ardhmen”.²³

Anarkia dhe frika vijuan edhe pas dorëheqjes së H. Prishtinës dhe caktimit të një kabineti teknik të kryesuar nga Idhomene Kosturi. Kabineti i Kosturit u bëri thirrje nëpunësve të larguar të ktheheshin në detyrat e tyre. Por, ministrat dhe deputetët e larguar nga grushti i shtetit nuk u kthyen, pasi e konsideronin të pasigurt jetën e tyre. Ata ishin informuar se qeveria e H. Prishtinës kishte dhënë urdhra për kapjen me çdo kusht të tyre. Gjendja në Tiranë ishte e nderë dhe kryeqyteti ishte nën kontrollin e fuqive civile të A. Pashës, H. Prishtinës dhe të M. Krujës.²⁴

Rezultatet e këtij grushti shteti ishin të rënda për shtetin e ri dhe institucionet e tij të brishta. Edhe pse dështoi, grushti i shtetit do ta radikalizonte më tej opozitën dhe do të acaronte në nivele kritike, marrëdhëniet e saj me qeverinë. Përveç kësaj, grushti i shtetit do të fuste në krizë të thellë Këshillin e Naltë, i cili pas zgjedhjeve, kishte mbetur i vetmi organ konsensual, i dalë nga Kongresi i Lushnjës.

Raporti i përgjithshëm i Komisionit Hetimor të LK, më 12 prill 1922, sqaronte se: “meqenëse fuqitë e Regjencës nuk u përcaktuan qartë në Kushtetutën e Lushnjës, kjo solli edhe komplikime të shpeshta, siç ishte kriza kushtetuese e dhjetorit”. Gjithashtu, ai vinte në dukje se, regjencia kishte pësuar një goditje të pariparueshme. “Në këto momente fuqia e Regjencës është fiktive, i vetmi autoritet real është në duart e qeverisë, e cila nga ana e saj, varet nga një dhomë e zgjedhur me votim indirekt”.

Raporti i lartpërmendur, ia atribuonte këtë ngjarje të rëndë, pra grushtin e shtetit, nivelit dhe mundësive të limituara që kishte shoqëria shqiptare për të adaptuar një regjim të tillë. Sipas tij: “në një vend ku mungon shtypi dhe ku pjesa më e madhe e zgjedhësve janë analfabetë, zgjedhjet gjithmonë do të varen nga një numër i vogël personash me influencë. Në përputhje me rrethanat, lufërat politike janë gjithmonë rivalitete personale, të cilat për shkak të traditës dhe karakterit të

²³ FO 371/7328, f. 214- 222, Raport i Komisionit Hetimor të LK për periudhën 19 nëntor - 20 dhjetor 1921.

²⁴ Teki Selenica, *Shqipria më 1927*, Tiranë: Tirana, 1928, f 93.

shqiptarëve, shkojnë gjithmonë drejt degjenerimit në konflikte me armë. Fuqia e politikanit matet më pak nga numri i zgjedhësve, sesa nga numri i personave të armatosur në dispozicion të tij. ...Ai ka mundësi, me mbështetjen e tyre, t'i imponojë vullnetin e tij qeverisë, e cila në shumë raste, ka një numër të kufizuar rezervash në dispozicion". Komisioni e konsideronte grushtin e shtetit si "veprim antikonstitucional i Hasan Prishtinës", i cili "me mbështetjen e dy regjentëve dhe nën forcën e armëve, pati sukses momentalisht në përmbysjen e qeverisë së Pandeli Evangjelit dhe në marrjen e pushtetit". Nga ana tjetër, Komisioni Hetimor, i jepte një rol parësor A. Zogut në shtypjen e grushtit të shtetit. Në raportin e tij shkruhej: "Në këto momente shfaqet Ahmet Beu, një kryetar i ri nën 30 vjeç, që posedonte influencë të madhe në vend, sidomos në Veri dhe që dukej e sigurt, që do të kishte një rol kryesor në të ardhmen e Shqipërisë. Ardhja e tij, së bashku me mijëra pasues, e detyroi Hasan Prishtinën, që ishte në fuqi prej tre ditësh, të largohet". Gjithashtu nënvizohej fakti se, "prezenca e Komisionit në Tiranë, pati efekt të dobishëm dhe mund të themi se parandaloi gjakderdhjen".²⁵

Në mbledhjen e parë, Parlamenti diskutoi për deputetët e prefekturës së Drinit, të cilët, kishin marrë pjesë ose kishin mbështetur grushtin e shtetit dhe gjithashtu, nuk kishin dalë nga zgjedhje të rregullta, pasi kjo krahinë kishte qenë e okupuar nga forcat jugosllave. Në këtë kohë, forcat jugosllave ishin tërhequr dhe Parlamenti vendosi t'u hiqte deputetëve mandatin dhe të zhvilloheshin në këtë krahinë zgjedhje të rregullta. Në botimin *Historia e Popullit Shqiptar*,²⁶ ky është vlerësuar si një veprim që thelloi krizën në vend.

Po në këtë seancë, Parlamenti dëgjoi dhe shpjegimet e P. Evangjelit për grushtin e shtetit dhe vendosi rrëzimin e dy anëtarëve të Këshillit të Naltë, Aqif Pasha dhe Imzot Bumçi, të cilët kishin drejtuar komplotin, duke i zëvendësuar këta me Imer Pashë Vrionin dhe me Ndoc Pistulin. Dy anëtarët e tjerë të Këshillit të Naltë, Abdi Toptani dhe Dr. Turtulli dhanë dorëheqjen pasi e konsideruan rrëzimin e kolegëve të tyre si shkelje të Statutit të Lushnjës. Në vend të tyre, Parlamenti zgjodhi Refik Toptanin dhe Sotir Pecin.²⁷

²⁵ FO 371/7329, f. 285-293, Raporti i përgjithshëm i Komisionit të Hetimit të Lidhjes së Kombeve, dt. 12 prill 1922.

²⁶ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. III, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 183.

²⁷ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 266.

Lidhur me krizën e dhjetorit 1921, ka pasur pikëpamje të ndryshme në historiografi. Historiografia e mëparshme, e ka përcaktuar atë thjesht si krizë e shkaktuar nga pakënaqësia dhe shqetësimi i kundërshtarëve të A. Zogut, për forcimin e pozitave të tij në “Partinë Popullore”, dhe në qeveri, dhe nuk e kanë përmendur asnjëherë termin “grusht shteti”.²⁸ Këto ngjarje, trajtohen si një krizë politike, e nuk përmendet përcaktimi “grusht shteti”, ndonëse tërthorazi, lihet të kuptohet se rrëzimi i qeverisë së P. Evangjelit, ishte jolegjitim. “Si shkak i rrëzimit të qeverisë së P. Evangjelit, cilësohet caktimi prej saj i A. Zogut, si komandant i operacionit në Mirditë”. Ndihmën e Zogut për shtypjen e grushtit të shtetit, autorët e lartpërmendur e kanë vlerësuar vetëm si përpjekje për të realizuar ambiciet e tij për pushtet.²⁹ Edhe Arben Puto, i ka cilësuar si kriza qeveritare dhe lë të kuptohet se ato u shkaktuan nga ambiciet e Zogut, i cili kishte mbetur jashtë qeverive të periudhës tetor-dhjetor. Grushtin real të shtetit, ai e injoron dhe e quan në thonjëza një “puç” “antikushtetues”.³⁰

Opozita e kohës, u përpoq ta justifikonte grushtin e shtetit dhe ta paraqiste atë si një ngjarje pa ndonjë rrezik të madh për vendin. A. Këlcyra, personalitet politik me influencë i asaj kohe, pohon se qeveria e P. Evangjelit, nuk qe aspak në lartësinë e misionit të vet. Kjo qeveri, u quajt nga disa krerë të Veriut si H. Prishtina, M. Kruja, Z. Dibra, si qeveri kukull për të përgatitur sheshin e vendosjes së diktaturës së organizatës së fshehtë (“Klikës”).³¹ Kuptohet që ky justifikim, duket mjaft i dobët përballë këtij akti të rrezikshëm. Nga ana tjetër, askush nuk ka vënë në dukje rrezikun e këtij grushti shteti. Ky i fundit, në fakt, ishte një rrezik i madh për Shqipërinë. Me të drejtë, J. Tomes pohon se: “shkatërrimi i qeverisë shqiptare në më pak se një muaj pas njohjes diplomatike, kërcënonte të rihapte “Çështjen Adriatike”, pikërisht në momentin që mendohej se ajo po shkonte drejt zgjidhjes”.³²

Por, jo vetëm që kishte ndodhur një grusht shteti, por, për më tepër ky solli në fuqi një pjesë të opozitës dhe pikërisht Komitetin e Kosovës. Dhe kjo ndodhte, në një kohë, kur Konferenca e Ambasadorëve dhe

²⁸ *Historia e Popullit Shqiptar...*, III, f. 180-183.

²⁹ *Po aty*, f. 182-183.

³⁰ Arben Puto, *Shqipëria Politike (1912-1939)*, Tiranë: Toena, 2009, f. 320-322.

³¹ A. Këlcyra, *Shkrime për historinë e Shqipërisë ...*, f. 86.

³² J. Tomes, *King Zog of Albania- Europe's ...*, f. 47-48.

Këshilli i Lidhjes së Kombeve, i kishin kërkuar Jugosllavisë të tërhiqte të gjitha forcat e saj nga territori shqiptar, deri më 10 dhjetor. Kështu, marrja e frenave të qeverisjes me një grusht shteti nga Hasan Prishtina dhe Komiteti i Kosovës, ishte një politikë aventureske shumë e rrezikshme, veçanërisht në këtë moment kritik.

Kriza e dhjetorit 1921, solli edhe rigrupimin e forcave në Parlament. A. Zogu dhe përkrahësit e tij, morën epërsinë në “Partinë Popullore”. “Partia Përparimtare” u shpërnda.

Më pas, një pjesë deputetësh të “Partisë Popullore” dhe asaj “Përparimtare” u bashkuan, duke formuar opozitën në Parlament. A. Puto e ka cilësuar “Partinë Popullore” si të djathtë e vendit, ndërsa opozitën si e majta,³³ por, është e vështirë që ky përcaktim të konsiderohet si i saktë, për arsye se bindjet politike brenda dy grupeve ishin heterogjene. Madje, shumë fakte dhe politikanë të kohës, pohojnë se “Partia Progresive” ishte më konservatore dhe ajo “Popullore” ishte më liberale.

Roli i Zogut në shpartallimin e grushtit të shtetit, e rriti prestigjin dhe influencën e tij brenda vendit, por njëkohësisht edhe armiqtësinë kundër tij. Gjithashtu, edhe diplomatët e huaj në vend, e vlerësuan atë, si një njeri që imponoi një lloj rregulli. Ministri britanik Eyres, njoftonte se: “Ahmet Beu ishte shpirti i kabinetit dhe një udhëheqës natyral dhe se nuk kishte arsye të besohej pretendimi i armiqve të tij, se ai synonte të merrte pushtetin absolut në Shqipëri”.³⁴

Tashmë, “Partia Popullore” kishte një shumicë dërrmuese në Parlament. Përkohësisht, opozita kishte pësuar një goditje të rëndë. Qeveria dhe shumica u gjend para dilemave se çfarë masash duhej të merrte ndaj organizatorëve të grushtit të shtetit, masa ligjore, të cilat do të ishin radikale apo masa politike oportuniste. Sipas Sejfi Vllamasit, disa qeveritarë, parlamentarë dhe anëtarë të Krahit Kombëtar, ishin për masa ligjore radikale, për t’u dhënë një mësim të mirë aventurierëve, ambiciozëve dhe veglave të huaja. Por, pas shumë diskutimeve, shumica vendosi për një politikë oportuniste kundrejt autorëve të grushtit të shtetit, me qëllim që në opinionin e huaj të mos kuptohej se ishte kryer një grusht shteti, aq më tepër kur Komisioni i Lidhjes së Kombeve ishte duke kryer misionin e tij në Shqipëri. Shumica mendoi se, këto duhej të paraqiteshin si ngjarje me pak rëndësi dhe të dukej se çdo ndryshim ishte

³³ A. Puto, *Shqipëria Politike ...*, f. 317.

³⁴ J. Tomes, *King Zog of Albania- Europe's...*, f. 48.

bërë me vendimin e Parlamentit dhe situata ishte normalizuar pa gjakderdhje.

Në komplot rolin kryesor e kishin luajtur Aqif Pasha, Hoxha Kadriu dhe Qazim Koculi, të cilët, në shumë raste, i kishin bërë shërbime të mëdha atdheut. Kështu, qoftë nga pikëpamja morale, qoftë nga ajo praktike, masat radikale nuk ishin të përshtatshme. Gjithashtu, qeveria nuk dispononte një fuqi të organizuar mirë për t'i bërë ballë çdo reagimi që mund të vinte si pasojë e masave të tilla.³⁵ Ndërkohë, Mustafa Kruja u arratis në Jugosllavi, Hasan Prishtina nuk u paraqit për të dhënë shpjegime në qeveri, por u mbyll në shtëpinë e tij. Qeveria fillimisht e rrethoi shtëpinë e tij, por pastaj, për të evituar një gjakderdhje, vendosi ta lirojë me kusht që të dilte jashtë Shqipërisë.³⁶

Gjithë rrëmujën e këtyre ngjarjeve të dhimbshme, e trajtonte edhe përfaqësia britanike në Shqipëri, vlerësimet e së cilës, janë të ngjashme me ato të Komisionit Hetimor të Lidhjes së Kombeve, por kanë edhe diferenca dhe detaje të tjera interesante. Analiza e H. Smith, niste me formimin e “Bashkimit të Shenjtë”.

Këtu duhet theksuar se, ndryshe nga vlerësimet që ka bërë S. Vllamasi, ai i jepte një rol A. Zogut në këtë lëvizje politike. Këtë fakt e kemi përmendur edhe pak më lart, por tashmë, Smith shprehej edhe më qartë në bindjen e tij. Nën titullin “Gjyqi i fuqisë në tetor i shmangur nga krijimi i kabinetit të improvizuar të Evangjelit”, Smith shkruante: “Ardhja në fuqi e “Partisë Popullore” në tetor, me kryeministër Pandeli Evangjelin, nga pamja e jashtme duket normale, por në realitet fsheh një krizë tashmë të lindur. Falë mbështetjes së Ahmet Zogut, “Bashkimi i Shenjtë” u mbivotua në krahasim me qeverinë “Bejlerë” të Ilias Bej Vrionit. Historia e brendshme e ngjarjeve të fundit, ka të bëjë me përpjekjen e Ahmet Zogut për të kapur frenat e qeverisë. Megjithatë, ai vuri re, që partitë opozitare, Aqif Pasha, Hasan Beu dhe të tjerët ishin tepër të vështirë për t'u mposhtur; dhe zgjidhja u gjet me kompromisin e krijimit të kabinetit të të dobtit dhe të ndershmit Evangjel”.³⁷ Smith theksonte se kabineti, sigurisht u formua sipas mënyrës së parashikuar në Kongresin e Lushnjes dhe se partitë në konflikt ranë dakord për tre

³⁵ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 267-268.

³⁶ *Po aty*.

³⁷ FO 371/7330, f. 581-586, Telegram i Heathcote Smith për Curzon, dt. 18 janar 1922, mbi situatën politike në vend.

arbitra, të cilët duhej të shpërndanin ministrinë në mënyrë të barabartë mes dy grupeve. Diplomati anglez, zbulon se Bajram Fevziu ishte kandidati i Ahmet Zogut, ndërsa kundërshtarët e tij kishin Zija Bej Dibrën.

Ndërsa, duke komentuar grushtin e shtetit të dhjetorit 1921, Smith e quante atë me emrin e tij të vërtetë, pra grusht shteti. Madje ai e kishte konceptuar si “*Seritë e “coups d’Etat”* duke ja atribuuar këtë secilës parti. Ai përcaktonte konkretisht këta autorë përgjegjës: (a) Aqif Pasha; (b) Hasan Beu; (c) Ahmet Beu. Si shkaktar fillestar të këtyre veprimeve antikushtetuese, ai rendiste Aqif Pashën dhe bashkëpunëtorët e tij, Qazim Koculin dhe Hasan Prishtinën. Ashtu si shumë burime të tjera, Smith vërtetonte se, planet e Regjentit dështuan për arsye personale, ngaqë “personat e afërt me Qazim Beun, duke u frikësuar se ky bashkëpunim ishte i destinuar të dështonte, refuzuan të bashkëpunonin”. Ai shton se “Aqif Pasha ishte në një dilemë të rëndë. Ai kishte hedhur poshtë z. Evangjeli me një *coup d’Etat* dhe tani ishte i paaftë të vendoste një kabinet në vend të tij”.

Siç theksuam më lart, përgjegjësia e Aqif Pashës, veçohet. Smith nënvizonte: “Duhet të shihet se në krye të paligjshmërisë së parë, është Aqif Pasha, i cili u konsiderua se kishte vepruar *ultra vires*, duke refuzuar të firmoste dekretet që iu paraqitën atij për ministrat e Evangjelit. Kjo u pasua nga shumë abuzime mbi regjimin e vendosur nga Statuti i Lushnjës, që në të vërtetë, krijoi një gjendje të vështirë ligjore”.³⁸

Një informacion tjetër shtesë dhe interesant i Smith, është ai se në këtë dilemë, Aqif Pasha u shtrëngua të caktonte kryeministër Hasan Prishtinën. “Pa qef dhe kundra vetes së tij, ai u kthye te Hasan Bej Prishtina, i cili kishte një të shkuar aventurioze dhe ndjenja të dhunshme pro-italiane dhe anti-jugosllave. Më tej, ishte edhe rivaliteti i fortë që ekzistonte mes tij dhe Ahmet Zogut”. Smith nënvizonte dhe faktin se: “zgjedhja e një irredentisti kosovar krijoi natyrshëm një situatë të tendosur”. Jo vetëm kaq, por ai mban qëndrim kritik edhe ndaj masave që mori qeveria e H. Prishtinës, për të cilin thotë se, “në mënyrë të pamatur dhe të guximshme, duke pasur kabinetin gati, mori në dorëzim postet në vend, dhe më 8 dhjetor, mori masa kundër “Klikës”. Ai dha urdhër për disa arrestime dhe e liroi Ahmet Zogun nga komanda”. Pra, Smith konfirmon faktin, tashmë të përmendur gjerësisht, nga Vllamasi, Selenica

³⁸ Po aty.

e të tjerë, se H. Prishtina dha urdhëra për arrestimin e politikanëve kundërshtarë, të cilët, në fakt, ishin deputetë të “Partisë Popullore”, duke çelur kështu siparin e degradimit të konfliktit politik në dhunë politike. Më tej, afirmohet edhe fakti se pa pritur urdhërat e Zogut, i cili ndodhej në malet e Mirditës, disa anëtarë të “Klikës” (“Partisë Popullore”), u larguan nga Tirana, me disa qindra trupa, për të organizuar rezistencë në provinca.

Smith flet edhe për ardhjen e A. Zogut në Tiranë, pas katër ditësh, pra më 12 dhjetor, me forca të konsiderueshme. Telegrami më tej shton se, “ndërkohë që Ahmet Zogu iu afrua kryeqytetit, Kosturi u vendos kryeministër ad interim”. Diplomati britanik, pohon faktin se, Zogu në këto momente përqendroi në dorë gjithë pushtetin por, nënvizon edhe frymën e kompromisit që ai tregoi me autoritetet ekzistuese të implikuara në grushtin e shtetit. Ai shkruan: “Duke hyrë në Tiranë, pa kundërshtime, ai mori drejtimin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë dhe për pak sundoi si një diktator virtual. Kryeministri ad interim, duke treguar takt dhe durim, protestoi butësisht. Gradualisht Ahmeti u lejoi autoriteteve ekzistuese të merrnin përsëri kontrollin”.³⁹

Po kaq interesante, janë edhe gjykimet e Smith për masat që u morën pas dështimit të grushtit të shtetit. Ai e konsideron të paligjshëm qëndrimin e Parlamentit kundrejt Regjentëve. Smith shkruante: “në mënyrë të paligjshme, thirrën Aqif Pashën dhe Bumçin, të abdikonin nga Regjenca, duke zgjedhur në mënyrë të paligjshme anëtarët për katër vendet vakante, pasi dy anëtarët e tjerë të Regjencës kishin dhënë dorëheqjen në shenjë proteste”. Një kritikë tjetër, drejtohej ndaj krijimit të Gjykatës së Lartë, që do të gjykonte autorët e grushtit të shtetit. Sipas tij: “Parlamenti kishte votuar një ligj me fuqi prapavepruese, me anën e të cilit, u krijua një Gjykatë e Lartë, për të gjykuar Ministrat apo deputetët që kishin vepruar kundër kushtetutës. Gjykata përbëhej nga 6 anëtarë të Gjykatës së Kasacionit, 5 anëtarë të emëruar nga Regjenca dhe 5 të emëruar nga Parlamenti”. Smith pohonte se, “tre kryeministra si Evangjeli, Koculi dhe Hasan Prishtina do të dënoheshin: I pari, për mosveprim, i treti, pasi kishte përdorur forcë dhe i dyti, pasi kishte përfituar nga situata ilegale. Ish-Regjentët, siç u vendos, ishin të papërgjegjshëm përpara ligjit dhe nuk do të gjykoreshin”. Siç shihet britanikët ishin për masa të lehta ndaj pjesëmarrësve të grushtit të shtetit

³⁹ Po aty.

dhe ata shikonin shkelje të ligjeve nga qeveria e asaj kohe në masat që ajo mori për eliminimin e pasojave të krizës së dhjetorit 1921.

Pas kësaj krize, përfaqësuesit britanikë, kanë bërë një analizë të rëndësishme të sistemit politik në Shqipëri, duke u munduar të parashikonin edhe pasojat që do të kishte zbatimi i tij më tej. Është interesante se, ata parashikuan destabilitetin që do të vinte. Smith pohonte se, “kabineti, i zgjedhur më 25 dhjetor dhe i drejtuar nga Xhafer Ypi, ishte i vendosur të mos thirrte Asamblenë Kushtetuese, derisa të përcaktoheshin kufijtë”. Për pasojë “çështja e fuqisë sovrane në të ardhmen do të mbetej pezull”. Me “fuqi sovrane”, ai nënkuptonte një autoritet të lartë shtetëror, pra kreun e shtetit, me fuqi të gjëra për të dominuar situatën politike në vend. Smith theksonte se, “ndërmjet të gjithë shqiptarëve është kuptuar se, që këtu të mbizotërojë paqja e brendshme, një autoritet i fortë dhe i respektueshëm duhet të vendoset ose të pranohet vullnetarisht nga vendi. Vonesat e mëtejshme në pranimin e kësaj zgjidhje fundamentale, shihen si vazhdim i një periudhe pasigurie dhe trazirash”.⁴⁰

Ai, përpiqej të gjente dhe ilaçin e shërimit të kësaj situatë të rrezikshme. Diplomati anglez i shkruante Lordit Curzon: “Ka mundësi që do të jetë thirrja e Asamblesë Kushtetuese dhe vendosja e Monarkisë, ajo që do të bashkojë ato që krijuan lëvizjet e kaluara politike në vend”. Por nga ana tjetër, ai shihte si një rrezik marrjen e masave të rënda ndëshkuese nga Gjykata e Lartë, për të cilën theksonte se “ka fuqi mbi jetën dhe vdekjen”, ndaj kabinetit të Hasan Prishtinës. Në një rast të tillë, ai parashikonte, se problemet mund të vazhdonin.

Gjithashtu, ai i sigurt paralajmëronte se qeveria e Ypit, “po qëndronte në fuqi duke u mbështetur në forcën fizike që u përdor për ta marrë atë, dhe se kundërshtarët e saj do të përpiqeshin ta rrëzonin atë, nëse ishte e nevojshme me anën e forcës, për sa kohë që ata ndiheshin të fuqishëm për ta bërë një gjë të tillë”.⁴¹

Si pengesë kryesore “në rritjen e Shqipërisë”, ai konsideronte sistemin politik që ajo kishte adaptuar. Lidhur me këtë, Smith shkruante: “Si përfundim, mund të thuhet se, mosmarrëveshjet e shumta në Shqipëri lindin nga nevojat që sjell loja në një qeverisje parlamentare të trilluar”. Në imazhin e tij, i vetmi element stabilizues ishte një sovran i fortë dhe i

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ Po aty.

fuqishëm ushtarakisht dhe politikisht. Ky do të ishte garanti i vetëm i stabilitetit dhe qeverisjes efektive të vendit. Smith theksonte: “Duke qenë aty një sovran i fortë me fuqi mbikqyrëse të përshtatshme, duke formuar një bërthamë ushtarake nga disa mijëra njerëz të tij, dhe një këshill legjislativ përfaqësues, por i nominuar gjerësisht, i lidhur me autonominë lokale të provincave më të zhvilluara, siç është Shkodra, ndërsa do të ketë qëllime të shumta për energjitë dhe aktivitetet rajonale, makineria e qeverisë qendrore, do të ketë mundësi të punojë, e lirë nga ndërhyrjet, për zhvillimin gradual të vendit”.⁴² Në përfundim, ai e theksonte me forcë edhe një herë, se qeverisja e atëhershme, ishte tërësisht e papërshtatshme. Sipas tij: “Shqipëria, si një e tërë, nuk është akoma gati të trajtojë organizmin delikat të demokracisë kushtetuese. Një makineri e komplikuar në duart e njerzve primitivë është e rrezikshme. Nëqoftëse Shqipëria do të mbante, që në fillim, një kushtetutë demokratike me të drejta të plota dhe pa kontroll nga lart, vështirë se do të kishte më tepër progres, për shkak të lirisë së tepruar”.⁴³

Një interes të veçantë paraqet tabloja që Smith i dërgonte Londrës mbi fuqinë e krerëve shqiptarë dhe lidhjet që ata kishin midis tyre, të cilën po e japim të plotë në fund të artikullit.⁴⁴

Kriza e thellë e dhjetorit 1921 dhe roli që mori A. Zogu për shtypjen e grushtit të shtetit, e evidentuan atë, si njeriun më të fuqishëm të Shqipërisë. Pikërisht në këto çaste, britanikët analizuan edhe profilin e tij politik. Heathcote-Smith i shkruante Lordit Curzon: “Në politikën e brendshme ai ka përdorur ose ka shpërdoruar pushtetin e tij për të pasuruar veten, me qëllimin për ta përdorur këtë pasuri për konsolidimin dhe rritjen e prestigjit të tij. Ai nuk paraqiti asnjë reformë por, ishte gjithmonë i zënë duke manipuluar njerëzit dhe ngjarjet, në mënyrë që t’i bënte ndërhyrjet e tij të domosdoshme në të gjitha rastet. Ai flet rrallë në Parlament, por kukullat e tij merrnin diktatin e tij në letër. *Coup d’Etat* i tij, në krizën politike të fundit, u relatua prej meje më 10 janar. Anullimi prej tij i zgjedhjeve të Drinit, ku ishin praktikisht të gjithë kundërshtarët e tij në Parlament, solli privimin e tyre nga postet politike dhe ishte një kryevepër në strategjinë e tij. “Klika”, krijimi sekret i Ahmet Zogut, tashmë kontrollon Shqipërinë. Në mënyrë aksidentale, ajo ka marrë

⁴² Po aty

⁴³ Po aty.

⁴⁴ Po aty.

pjesërisht hije anti-turke, ku anëtarët janë bashkuar, për të parandaluar shqiptarët që më parë kanë punuar në administratën civile apo ushtarake në Turqi dhe që po zinin postet më të mira. Megjithëse, pakënaqësia mbi regjimin e frikës dhe të burgosjes së krijuar nga “Klika” është mjaft e përhapur, një pjesë e vogël e opinionit publik e sheh një gjë të tillë, si të natyrshme”.⁴⁵

Kjo, është një parashtrësë shumë interesante. Ajo që mund të diskutojmë rreth saj, është fakti se, në dy çështje themelore, ajo bie në kundërshtim me pikëpamjet që kanë shprehur pjesëmarrës të këtyre ngjarjeve. Kështu, p.sh. Sejfi Vllamasi, i cili e portretizon “Klikën” me emrin e saj të vërtetë, Krahu Kombëtar, e paraqet atë si një organizatë patriotike nacionaliste dhe progresive e themeluar në ditë të vështira dhe që kishte si qëllim ngritjen e shtetit kombëtar të pavarur. Po kështu, edhe veprimtarinë e Zogut në këtë kohë, e ka vlerësuar si pozitive dhe të dobishme dhe në shërbim të rendit dhe stabilitetit të vendit. Ndërsa ardhja e tij me forca ushtarake pas grushtit të shtetit në dhjetor 1921, është vlerësuar, si një veprim korrekt në favor të vendosjes së kushtetutshmërisë pas këtyre tronditjeve serioze të saj.⁴⁶

Disa muaj më vonë edhe shefi i Smith, ministri H. Eyres, do ta ndryshonte dukshëm këtë mendim rreth këtyre qëndrimeve ndaj A. Zogut, duke evidentuar respektimin e metodave ligjore prej tij dhe energjinë që ai solli në qeverisje, për stabilizimin e vendit.

⁴⁵ FO 371/7330, f. 620-623, Telegram i Heathcote-Smith për Curzon, në lidhje me A. Zogun, Ministrin e P. Të Brendshme, dt. 18 shkurt 1922.

⁴⁶ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 265-266.

Bashkangjitur: Liderët shqiptarë dhe forcat në dispozicion të tyre									
Emri dhe numri	Lidershipi mbi të cilin mund të mbështetet	Rajoni i pronave	Nr. i personave të gatshëm për të ndjekur thirrjen e tij	Natyrë e influencës	Rajone të tjera në të cilat shtrihet influenca e tyre	Numri i shqiptarëve që mund të jenë gatë të ndjekin thirrjet e tij	Vërejtje		
1	Aqif Pasha nga Elbasani	Peqin... Kavajë...	500 500	...	Në të gjithë Shqipërimë.	(?)	Ai nuk është i pasur. Një përgjigje e përhapur nëse bën një thirrje kombëtare.		
2	Shefqet bej Vërlaci nga Elbasani	Elbasan	1000	lokale	Asnjë	...	Njeriu më i pasur në Shqipëri. Jo ndonjë forcë e madhe në politikë, vjerri i mundshëm i nr. 3.(A. Zogu)		
3	Ahmet bej Zogolli nga Mati	Mati...	500	lokale	Mirdita dhe Korça.	(?)	Tepër i frikshëm, por i varfër për momentin. Fuqia e tij po rritet.		
4	Hasan bej Prishtina	Dibra...	500	lokale	Kosova...	(?)	Është i varfër, po të mos mbështetet nga nr. 1 (Aqif Pasha), nuk sjell ndonjë efekt.		
5	Kolonel Bajram Curri	Asnjë	Gjakova Kraçun Shkodër Malësi Mirdita	(?) (?) 1000 4000 (?)	Një veteran analfabet, një patriot i jashëzakoshëm, që ka luftuar me sukses ndaj turqve, ka udhëhequr trupat kundër italianëve dhe jugosllavëve. Ai është i dashur nga të gjithë, ka arrestuar të gjithë esadistët.		
6	Mustafa Kruja	Kruja..	50	lokale	Influencë morale në Shqipërinë Qendrore.	..	Dijetar dhe i lëkundur. Mendohet se paguhet nga italianët.		
7	Hamid bej Topiani	Shijak... Durrës...	1000 1000	lokale	Asnjë	..	I frikshëm dhe i paskrupull.		

8	Abdi bej Toptani	(?)	Tirana... Kruja...	2000 1500	lokale	Asnjë	..	Popullor, i qetë dhe Ish-Regjent.
9	Qazim bej Koculi	Nr. 1 (Aqif Pasha) dhe veija e tij.	Vlora.. Gjrokastra...	(?)	Në të gjithë Shqipërimë, veçanërisht në Jug.	2000 3000	Udhëhoqi popullsinë kundër italianëve , duke i larguar ata nga Vlora më 1920. Tepër i respektuar, patriot por, intrigant.
10	Myfid bej Libohova	Nr. 4 (Hasan bej Prishtina) (?)	Libohova	200	lokale	Gjithashtu një influencë morale të gjerë.	..	Në dyshim, pasi ishte ministri i vetëm i mbetur me italianët. Anëtar i qeverisë së Durrësit, kur nr. 9 (Qazim bej Koculi) dëboi italianët.
11	Omer Pashë Vrioni	(?)	Berat..	800	lokale	Gjithashtu një influencë morale të gjerë.	..	Shumë i vjetër dhe i respektuar. I pasur, i pavarur, vjerri i Aqif Pashës dhe Shefqet Beut. Tani Regjent.
12	Marka Gjoni	veija e tij	Mirdita..	2000	lokale	Disa ndikime në Bajraçet e mbetura.	..	Marka Gjoni, tani është një intrigant në mëngim në Jugosllavi. Drejtues trashëgimtar i Mirditës me influenca atje.
13	Ndoc Pistulli	(?)	Shkodër Dukagjin Mirdita (?)	(?)	lokale	Ndërmjet maësorëve të krishterë.	..	Tani Regjent. Ka marrëdhënie të mira me legatën e Papatit, mbi të cilët kishte një influencë të konsiderueshme. Është një tregtar nga Shkodra, me një botkuptim të mirë politik.
<p>Lista e mësipërme është më tepër përfaqësuese sesa shteruese. Shënime të tjera: Numrat 1 (Aqif Pasha), 2 (Shefqet bej Vërtaci) dhe 3 (Ahmet bej Zogolli) kanë një status gjysëm-feudal.</p>								

*S u m m a r y*THE BEGINNINGS OF THE INSTITUTIONAL DEMOCRACY IN ALBANIA
1920-1921

In 1920-1921 Albania was making its first steps towards a state organization.

At that time there were founded and consolidated the state's constitutional institutions. Some important achievements were: the first parliamentary elections, the establishment of the first political parties and their parliamentary activity. These developments brought about the creation of a parliamentary opposition and the first publications in the field of constitutional right.

As a result of the political contradictions in the National Council, an institution founded in the Congress of Lushnje, it became necessary to approve a new election law and the first parliamentary elections were held. As a result, the political groupings that would compete in these first parliamentary elections were created.

The establishment of the opposing political groups in representative bodies such as the Parliament or the Senate are clearly basic and functional features of parliamentary systems. However, the problems that arose in Albania came as a result of the fact that these political groups did not represent opposing political views but just differences based on their regional background and personal ties.

During this time, the representative institutions were extremely unstable and the level of political responsibility among the Albanian political elite still low. This elite preserved several negative characteristics and had a lack of knowledge about the national politics and institutions, was unable to reach a political consensus, had no vision about the development of the country and did not recognize the need for stability at a time when all the above were badly needed in Albania.